

Në bazë të nenit 35 paragrafi 16 nga Statuti i Ndërmarrjes publike “ Higjiena komunale”- Shkup dhe nenet 10,12,13,14 dhe 15 nga Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.7/05; nr.103/08; nr.124/10; nr.135/11; nr.43/14; nr.153/15 dhe nr.99/16) drejtori i NP “Higjiena komunale”- Shkup, në ditën 22.03.2018, solli

Udhëzim

për realizimin e së drejtës së qasjes dhe korigjimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave personale

Ndërmarrja publike “Higjiena komunale”- Shkup (në tekstin e mëtejshëm - Ndërmarrja publike) në brendësin e sferës së saj dhe për të kryer veprimtarinë e saj në interes të publikut nga sfera e shërbimeve komunale kryen përpunimin e të dhënave personale.

Nga aspekti i mbrojtjes të të dhënave personale, Ndërmarrja publike është Kontrollues i të dhënave personale kurse subjektet e të dhënave personale janë punonjësit, shfrytëzuesit e shërbimeve të Ndërmarrjes publike si dhe subjektet tjera të të dhënave personale, të dhënat personale të cilat përpunohen nga Ndërmarrja publike.

Udhëzimi i përshkruan të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, procedurat për informimin e subjektit të të dhënave personale duke dorëzuar kërkesë nga ana e subjektit të të dhënave personale për qasje deri te të dhënat personale, ndryshim, plotësim dhe fshirjen e të dhënave personale si dhe të ndaloj përpunimin e të dhënave nëse ato nuk janë të plota, të pasakta apo jo të azhurnuar përderisa përpunimi i tyre nuk është në përputhje me ligjin si dhe kufizimi i së drejtës të subjektit të të dhënave personale.

1. Të drejta të subjektit të të dhënave personale

Kur Ndërmarrja publike mbledh të dhëna personale, subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të informohet për:

- identitetin e Ndërmarrjes Publike;
- të gjitha në përpunim;
- shfrytëzuesit ose kategoritë e shfrytëzuesve të të dhënave personale;
- detyrimi për të dhënë përgjigjet e pyetjeve;
- pasojat e mundshme nëse nuk jepet përgjigje dhe
- ekzistenca e së drejtës për qasje dhe e drejta e korigjimit të të dhënave të tij personale.

Ndërmarrja publike nuk është e obliguar ta informojë subjektin e të dhënave personale në qoftë se ai është i njoftuar paraprakisht me punën e përmendur në paragrafin 1 alinea nga 1 deri 6 nga kjo pikë.

2.Kërkesë për qasje/informim për të dhënat personale

Subjekti i të dhënave personale mund të kërkoj qasje dhe të informohet:

- a kryhet përpunimi i të dhënave personale të tij;
- për qëllimet dhe bazën ligjore të përpunimit të të dhënave personale dhe shfrytëzuesve ose kategorive të shfrytëzuesve të cilëve u zbulohen të dhënat personale;
- për të dhënat personale në lidhje me subjektin e të dhënave personale dhe burimit i të dhënave dhe për logjikën e përpunimit të automatizuar në rast të vendimit të marrë, në bazë të përpunimit automatik i cili ka ndikim mbi subjektin e të dhënave personale.

Për realizimin e të drejtës për qasje subjekti i të dhënave personale parashtron Kërkesë për dorëzimin e informatave për përpunimin e të dhënave personale deri te Ndërmarrja publike, (Formular nr.1) i dhënë në shtojcën e këtij udhëzimi , e publikuar në faqen e internetit të Ndërmarrjes publike.

Kërkesa e paraqitur e verifikuar në sekretariat/Arkiv e Ndërmarrjes publike përcillet deri te oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili i mbledh informatat e nevojshme për përpunimin e të dhënave personale të subjektit dhe i njofton për përgjigjet e kërkesave ndërsa në rast të mungesës së oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale deri te personi përgjegjës për mbledhjen e të dhënave personale.

Ndërmarrja publike është e obliguar që t'i përgjigjet kërkesës nga subjekti i të dhënave personale me afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës në sekretariat/Arkiv e Ndërmarrjes publike.

Kur Ndërmarrja publike i është përgjigjur kërkesës së subjektit të të dhënave personale nga paragrafi 1 nga kjo pikë, nuk e ka për obligim t'i përgjigjet përsëri kërkesës së njejtë ose të ngjashme të atij subjektit nëse në ndërkohë nuk ka ndryshime në të dhënat e tij personale përveç nëse kanë kaluar 6 muaj nga dita e dorëzimit të kërkesave të mëparshëm deri te kërkesa e re.

3.Kërkesa për plotësim, ndryshim dhe fshirje të të dhënave personale

Subjekti i të dhënave personale mund të kërkoj nga Ndërmarrja publike t'i plotësoj, ndryshoj dhe fshij të dhënat e saj personale.

Me kërkesë të subjektit të të dhënave personale, Ndërmarrja publike është e detyruar t'i plotësoj, ndryshoj ose t'i fshij të dhënat personale të subjektit në qoftë se ato nuk janë plota, të pasakta ose jo të azhurnuara dhe përderisa përpunimi i tyre nuk është në përputhje me LMDHP.

Kur kërkesa me shkrim dorëzohet deri te sekretariati/Arkivi i Ndërmarrjes publike nga subjekti i caktuar i të dhënave personale, ai atë e dokumenton me qëllim për formular të veçantë, Kërkesë për mbushje, ndryshim dhe fshirje e të dhënave personale (Furmaluari nr.2) të dhënë shtesë të këtij udhëzimi, të publikuar në faqen e internetit të Ndërmarrjes publike.

Kërkesa i përcillet oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale ndërsa në rast të mungesës së tij, deri te personi përgjegjës për përmbledhjen e të dhënave personale.

Ndërmarrja publike është e detyruar t'i përgjigjet kërkesës së subjektit të të dhënave personale më së voni 30 ditë nga dita e pranimi të kërkesës në sekretariatit/Arkivën e Ndërmarrjes publike.

Në rast kur Ndërmarrja publike vërteton se të dhënat personale nuk janë të plota, të pasakta ose nuk janë të azhurnuar është i detyruar të njejtat t'i plotësoj, ndryshoj ose fshij pavarësisht nga ajo nëse subjekti i të dhënave personale ka paraqitur një kërkesë për plotësimin ose ndryshimin e të dhënave personale.

Për plotësimin e përfunduar, ndryshimin ose fshirjen e të dhënave personale, në përputhje me paragrafin 6 të kësaj pike, Ndërmarrja publike është e obliguar më së voni në afat prej 30 ditëve të njoftoj subjektin e të dhënave personale dhe shfrytëzuesit eventual të të dhënave personale përveç nëse ajo është e pamundur ose nëse kërkon përpjekje disproporcionale ose shpenzime.

4.Kërkesa për ndalimin e përpunimit të të dhënave personale

Subjekti i të dhënave personale ka të drejt të kërkoj nga Ndërmarrja publike të ndaloj përpunimin e mëtejshëm të të dhënave të tij personale nëse ai përpunohet për këtë qëllim:

-kryerjen e punëve me interes publik ose autorizimin zyrtar të Ndërmarrjes publike ose për një palë të tretë të cilit i janë zbuluar të dhënat;

-përmbushjen e interesave legjitime të Ndërmarrjes publike, të palës së tretë ose person të cilit i janë zbuluar të dhënat personale përveç nëse çlirimi dhe të drejtat e subjektit të të dhënave personale nuk mbizotojnë mbi këto interesa.

Për këtë qëllim, si pjesë përbërëse e këtij udhëzimi është dhënë një kërkesë për ndërprerjen e përpunimit të të dhënave personale (Formulari ne.3) të publikuar në faqen e internetit të Ndërmarrjes publike.

Kërkesa i përcjellet oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në rast të mungesës së tij tek personi përgjegjës për mbledhjen e të dhënave personale.

Nëse kërkesa është e bazuar, Ndërmarrja publike është e detyruar të ndaloj përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale dhe t'i përgjigjet kërkesës më së voni se 30 ditë nga data e pranimit të kërkesës në Arkivën e Ndërmarrjes publike.

5.Kufizimet e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale

Të drejtat e subjektit të të dhënave personale të përcaktuara në pikat e mëparshme mund të kufizohen në raste të veçanta kur me praktikimin e tyre do të kanoset realizimi i detyrimeve të Ndërmarrjes publike të parashikuara me ligj dhe atë:

- për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit;
- për shkak të zbulimit dhe ndjekjes të kryerësve të veprave penale;
- për shkak të mbrojtjes nga lëndimet të së drejtës etike të profesionit të caktuar;
- për shkak së mbrojtjes të interesave të rëndësishme ekonomike apo financiare të Bashkimit Evropin ;
- për shkak së mbrojtjes e të drejtave dhe lirive të subjekteve e të dhënave personale ose të të drejtave të personave të tjerë fizikë.

Ky udhëzim së bashku me Formularin nr.1, nr.2 dhe nr.3 si shtesë, publikohet në faqen e internetit dhe në shpalljen e tabelës së Ndërmarrjes publike “Higjiena komunale”- Shkup.

NP “Higjiena komunale”- Shkup
Drejtor
Abdusamed Shabani

Përkthyen:
Merita Jusufi
Emira Hoxha

Data:
15.05.2018